POSTIM ARKIVOR

# Drita Çomo (1958-1981)




SEKSIONI

Artistë, shkrimtarë

PERIUDHA

1974 - 1983

Drita Çomo është vajza e Liri Belishovës dhe Maqo Çomos, ish-funksionarë të lartë të Partisë së Punës të cilët u zhveshën nga funksionet politike dhe shtetërore dhe u dënuan me burg dhe internim. Dosja e Drita Çomos është hapur në dhjetor të vitit 1974 dhe është mbyllur në vitin 1983 pas vdekjes së saj. Dosja është një rast i survejimit që ish-Sigurimi i bënte adoleshentëve që vinin nga kontingjent i familjeve antiparti.

DITAR · POETE · LIRI BELISHOVA · MAQO ÇOMO

PERMBAJTJE #1

# Kronologjia e survejimit të Drita Çomos

Dosja nr. 3497, “Drita Maqo Çomo”, përshkruan survejimin që iu bë Drita Çomos nga mosha 16-vjeçare deri në fund të jetës së saj të shkurtër, 23-vjeçare. Survejimi nisi në dhjetor të vitit 1974, pas disa informacioneve lidhur me qëndrimin e saj në aksion dhe vijoi rregullisht deri në vitin 1977, kur ajo u diagnostikua me një sëmundje të rëndë. Tri muaj përpara se të ndërronte jetë, ajo u vendos përsëri në përpunim 2B. Dosja përmban kronologjinë e planeve të masave, informatat nga bashkëpunëtorët dhe informacione të mara nëpërmjet teknikës operative. Në vijim do të paraqitet një kronologji e survejimit të Drita Çomos.

MEDIA #1

# Dosja nr. 3497 “Drita Maqo Çomo”

MEDIA FAQE #1


3497-A

TEPER SEKRET
Mod. 4

MINISTRIA E PUNEVE TË BRENDSHME
Dega e P. Brendshme
e Ana e Sigurimit

DEKLASIFIKUAR
AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

DOSJE FORMULARE

Kategorija 2. A Nr. ~~1554~~ 3235

për

(DRITA MAQO ÇOMO)

Fletë 76

Filluar 24-XII- v. 1974 Nr. Arshivës

Mbaruar 7. 4. v. 1977 Nr. Volumit

AIDSSH

Dosja nr. 3497 “Drita Maqo Çomo”

## INFORMACION

### Dosja nr. 3497 “Drita Maqo Çomo”

| | |
|---|---|
| FONDI | Operativ |
| DOSJA | Nr. 3497 |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Formulare |
| SASIA E FLETËVE | 101 |
| VITET EKSTREME | 1974-1983 |
| GJUHA | Shqip |

## TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

# Biografi

MEDIA FAQE #1



(6

BIOGRAFIA E DRITA MAQO COMOS ( BELISHOVA)

Drita Como eshte e bia e Maqos dhe e Lirise, e datlindjes 1958, lindur ne lagjen "[redacted]" te qytetit Tirane dhe banuse ne qytetin e Cerrikut te rrethit Elbasan, me arsim 2 te mesme, e pa martuar, e pa denuar, e pa organizuar, rrjedh nga shtrese N/Punsesh, me kombesi e shtetesi shqipetare.

Gjate regjimit te zogut, gjyshi i saje nga nena, ka sherbyer per nje kohe te gjate ne regjimin antipopullor te zogut, ndersa gjyshi nga baba ka shkuar ne mergim jashte shtetit per te siguruar buken e gojes, i cili ka qendruar atje deri sa ka vdekur.

Gjate okupacionit prinderit e saje, kane marre pjese nne levizjen Nac.Cl. deri ne çlirim e plot te vendit. Mbas clirimit deri ne vitn 1960, prinderit e Drites kane qene me detyra te rendesisheme partie e pushteti. Ne vitin 1960, per veprimtari armiqesore kunder partise te dy prinderit e saje jane perjashtuar nga partia dhe shkarkuar nga te gjitha fuksionet e partise e shtetit. Ne vitin 1961 jane internuar ne Kuç te rrethit Vlore, pastaj ne Progonat te rrethit Tepelene dhe e jema vazhdon me masen e internimit ne qytetin e Cerrikut te rrethit Elbasan, ndersa i jati i saje, ne vitin 1967, eshte denur me 10 vjet burg, mase te cilen eshte duke e vuajtur ne kampin e Burrelit. Aktualisht prinderit e saje nuk mbajne qendrim te mire politik.

Drita vazhdon vitin e dyte gjimnaz ne qytetin e Cerrikut dhe banon sebashku me te jemen e cila eshte e internuar.

Drita ka vella [redacted] Comon, i cili eshte me pune ne komunalen e Cerrikut, ka xhaxha [redacted] Comon me banim ne Tirane, ka dajor [redacted], [redacted], [redacted] dhe [redacted] Belishoven, ky i fundit eshte i denuar me 25 vjet burg, [redacted] eshte i perjashtuar nga partia

Te dhenat biografike jane marre nga dosja e t'jemes dhe biografie e t'jatit.

Puntori Operativ:
( Lutfi Nikaj )

Elbasan,me 29.12.1974.

AIDSSH

Biografi

## INFORMACION

## Biografi

| | |
|---|---|
| FONDI | Operativ |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Formulare |
| DOSJA | Nr. 3497 |
| VITET EKSTREME | 1974-1983 |
| DATA E KRIJIMIT | 29.12.1974 |
| PUNETORI OPERATIV | Lutfi Nikaj |
| GJUHA | Shqip |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Biografi |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

# Vendim i datës 24.12.1974

MEDIA FAQE #1



(8

"A P R O V O H E T"

SHEFI I SEKSIONIT

( Mehmet Tepelena )

Elbasan,me24/I2/I974

V E N D I M :

"Per marrjen ne perpunim P.P. te Drita Maqo Çomo(Belishova)"

Une, Puntori Operativ Lutfi Nikaj, mbasi studjova materja let ne ngarkim te Drita Maqo Comos (Belishova);

G J E T A :

Se, Drita Çomo, eshte e bija e Maqos dhe e Lirise, e dat-lindjes 1958, lindur ne lagjen "[redacted]" te qytetit Tirane dhe banuse ne qytetin e Cerrikut, me arsim dy te mesme (vazhdon gjimnazin e pa martuar, e pa denuar, e pa organizuar, rrjedh nga shtrese N/Punsesh, me kombesi e shtetesi shqipetare.

Ne vitin 1960, te dy prinderit e saje u perjashtuan nga partia dhe u zhgarkuan nga te gjitha fuksionet e partise e pushtetit si armiq te partise.

Ne vitin 1961, prinderit e saje per aktivitet armiqesor kunder partise, jane internuar. Kjo mase per te jemen vazhdon edhe sot, ndersa i'ati eshte denuar me 12 vjet burg.

Gjithashtu edhe dajat e saje, nuk mbajne qendrim te mire, mbasi [redacted] eshte denuar me [redacted] vjet burg, ndersa [redacted], [redacted] dhe [redacted] ndiqen aktivisht nga organet tona ne perpunim 2. A.

Nga degjimet me T.O; qe jane bere objektes "[redacted]" nenes Drites, rezulton se ajo zhvillon biseda me karakter armiqesor me Driten. dhe konkretisht: Ne pergjimin me T.O. dat. 13.I.1971, Drita ka thene: " Librat perndimore flasen me bukur, ato kane vepra te shkrimtarve te medhej". Me dat. 21.2.71, ka thene: " Gazetat thone se kjo lufte qe i behet revizjonizmit sot ne Shqiperi, eshte me shume heroike se lufta e Skenderbeut kunder turqeve".

AIDSSH

Vendim i datës 24.12.1974

MEDIA FAQE #2



(9

- 2 -

Me dat. 21.I.1974, ne lidhje me nje bisede qe ka bere nje shkrimtar ne shkollen e tyre per gabimet e Fadil Paçramit ne letersi, ka thene : " Ja,avazi i mukes, jane bere gabime si Fadil Paçrami , me qe ka dashur te mohoje frymen popullore. Ai po permbyste boten".

Ne mjaft raste mban veshje ekstravagante, gje per te cilen eshte kritikuar edhe nga drejtoria e shkolles dhe nuk ka reaguar drejt. Mban shoqeri me nxenes qe jane me perberje te keqe politike etj.

Duke u nisur nga te dhenat paraprake qe kemi ne ngarkim te Drita Comos qe flasen se zhvillon veprimtari armiqesore;

V E N D O S A :

Te marr ne perpunim P.P. per agjitacion e propagande Drita Maqo Comon (Belishova) per te vertetuar te dhenat e siperme dhe te sqaroj se deri ne ç'far shkalle ndikon te te tjeret.

Puntori Operativ:
(Lutfi Nikaj )

AIDSSH

Vendim i datës 24.12.1974

INFORMACION

## Vendim i datës 24.12.1974

| | |
|---|---|
| FONDI | Operativ |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Formulare |
| DOSJA | Nr. 3497 |
| VITET EKSTREME | 1974-1983 |
| SASIA E FLETËVE | 101 |
| DATA E KRIJIMIT | 24.12.1974 |
| GJUHA | Shqip |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Vendim për marrjen në përpunim |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #4

# Plan masash

MEDIA FAQE #1

(10)

"A P R O V O H E T"

SHEFI I SEKSIONIT

( Mehmet Tepelena )

Elbasan,me 25/I2/1974

## P L A N - M A S A S H

" Ne drejtim te perpunimit P.P. te Drita Maqo Çomos"

Me qellim per te vertetuar dhe dokumentuar veprimtarin armiqesore te Drita Çomos , ne perpunim P.P., do te merren keto masa agjenturalo - operative:

I- Do te bej biografine dhe lidhjet e saja familjare, miqesore dhe shoqerore.

Detyre qe do te kryhet deri 30.I.75
Kryhet nga P.OP. Lutfi Nikaj

2- Do te aktivizohet b.p. "Tomorri" per te pare levizjet dhe kontaktet qe ben ajo me persona te dyshem.

Detyre qe do te jete e vazhdushme
Kryhet nga Shefi Sek. M.Tepelena

3- Do te udhezohet b.p. "[redacted]" qe sa here qe Drita Como do te vije ne Elbasan, te krijoje mundesi e te takohet me te me qellim per te nxjerre se si reagon ajo aktualisht.

Detyre qe do te kryhet deri 20.2.75
Kryhet nga P.OP. Lutfi Nikaj

4- Do te koordinojme veprimet operative me P.OP. E.Zeneli , me qellim per te drejtuar agjenturen egzistuse qe ka ne shkolle ne Cerrik.

Detyre qe do te kryhet deri 30.3.75
Kryhet nga P.OP. L.N. e E.Zeneli.

5- Do te studjohen lidhjet e saja si ne shkolle ashtu e dhe jashte ne qytetin e Cerrikut dhe do te konkludohet per te terhequr nje b.p. ne drejtim te saje.

Detyre qe do te kryhet deri 30.3.75
Kryhet nga P.OP. Lutfi Nikaj

AIDSSH

Plan masash

MEDIA FAQE #2

(11)

- 2 -

6- Perpunimi i saje do te ndiqet se bashku me te jemes dhe dajes saje.

Detyre qe do te jete e vazhdushme
Kryhet nga P.OP. Lutfi Nikaj

7- Do te nxjerr ekstrat nga degjimet me T.O. qe i jane bere te jemes me Drita Comon (nga objekti"[redacted]") .

Detyre qe do te kryhet deri 30.I2.74
Kryhet nga P.OP. Lutfi Nikaj

8- Do te organizojme pergjimin me T.O. si ne banesen e saje dhe te [redacted].

Detyre qe do te kryhet deri 30.5.75
Kryhet nga P.OP. Lutfi Nikaj

9- Do te vihet ne kontroll korespondenca e saje, me qellim per te zbuluar lidhjet e saja familjare, miqesore e shoqerore qe ka ne rrethe te tjere.

Detyre qe do te kryhet deri 30.6.75
Kryhet nga P.OP. Lutfi Nikaj

I0- Ne rast se do te largohet jashte rrethit, do te organizohen masa koordinuse me rrethin ku do te shkoi, me qellim per ta pasur ne kontroll te plot.

Detyre qe do te jete e vazhdushme
Kryhet nga P.OP. Lutfi Nikaj

II- Do te merret ne surveim her mbas here me qellim per te zbuluar e fiksuar lidhjet e saja. Me keto lidhje do te veprohet sipas intresit operaiv.

Detyre qe do te kryhet deri 30.5.75
Kryhet nga P.OP. Lutfi Nikaj

I2- Do te koordinojme punen tone me vijen e masave per ta pasur ne kontroll te plot levizjet dhe kontaktet e saja me persona te tjere.

Puntori Operativ:
(Lutfi Nikaj )

AIDSSH

Plan masash

INFORMACION

## Plan masash

| | |
|---|---|
| FONDI | Operativ |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Formulare |
| DOSJA | Nr. 3497 |
| SASIA E FLETËVE | |
| DATA E KRIJIMIT | 25.12.1974 |
| PUNETORI OPERATIV | Lutfi Nikal |
| APROVUAR NGA | Mehmet Tepelena (shefi i seksionit) |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Plan masash |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #5

# Letër

MEDIA FAQE #1



(19

E K S T R A T:

Nxjerre nga letra qe Drita Mago Como (Belishova) i dergon t'jatit saje ne burg Mago Comos:

Te dashur babi dhe daje !

Tani po vjen pranvera. Koha eshte ngrohur, qielli eshte me re, me gjithe ate, ndjehet ardhija e saj. Ku do kane çelur mimozat. Sot ish 7 Marsi, dhe sikur mimozat kishin mbuluar gjithçka, pemet, tortuaret, rruget, bile edhe njerzit. Nuk shihje femij, pa lule ne duar. Te dukej se mbi toke kish rene nje shi i arte mimozash.

Ju derguam me pako ca dege, sigurisht kur t'i merrni, do jene thar. Por sidoqofte, do te ruajne diçka nga pranvera.

Sot po mendoja per jeten tone. Sigurisht ne nuk kemi qene aq te lumtur sa mund te ishim. Por me gjithe ate, s'eshte e vertete se ne nuk kemi qene te lumtur. Dhe jeta me te vertet eshte e bukur.

Po afrojne ditlindjet tona, babi. Te uroj jete te gjate dhe lumturi, nje lumturi te vertet dhe te plot. Te uroj, qe jeta te mos tregohet me aq e ashper me ty, siç eshte treguar deri tani, sepse ti je i fort, dhe e ke duruar ç'do gje i qete, sepse ti me gjith ate, gjithmone e ke dashur jeten. Dhe ty te puth fort,fort, nga larg. Edhe ty daja te puth fort, me mall.

Drita juaj.

Puntori Operativ:
( Lutfi Nikaj )

Elbasan, me 20.6.1975.

AIDSSH

Letër

INFORMACION

## Letër

| | |
|---|---|
| FONDI | Operativ |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Formulare |
| DOSJA | Nr. 3497 |
| SASIA E FLETËVE | 101 |
| VITET EKSTREME | 1974-1983 |
| DATA E KRIJIMIT | 20.06.1975 |
| GJUHA | Shqip |
| PUNETORI OPERATIV | Lutfi Nikaj |

| | |
|---|---|
| LLOJI I DOKUMENTIT | ekstrakt letre |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #6

# Relacion i datës 20.6.1975

MEDIA FAQE #1



(20

"M I R A T O H E T"

KRYETAR' I DEGES PUNVE TE BRENDESHME

/ GEZIM HILA /

Elbasan,me 20/6/1975

V E N D I M :

Mbi zgjatjen e afatit te perpunimit P.P. per 1 muaj te

Drita Mago Como(Belishova)

Une, Puntori Operativ Lutfi Nikaj, mbasi studjova materjalet ne ngarkim te Drita Mago Comos;

G J E T A:

Se, Drita Como, eshte marre ne perpunim P.P., me daten 26.12.1974, per agjitacion e propagande si lidhje e elementit anti-parti (vajza e Liri Belishoves).

Nga masat agjenturalo operative qe jane marre ne drejtim te saj, kane dale keto te dhena me te rendesishme:

Nga pergjimet me T.O. te organizuar me banesen e saje, ne biseda me t'jemen dhe vellain e saje eshte shprehur: "...... Kurse ne Shqiperi, ndodh e kunderta, librat shqipe flasen per jeten, por ato perndimoret flasen me bukur. Ata kane vepra te shkrimtarve te medhenj, nuk kane vepra te shkrimtarve te vegjel si ketu"....."Po gazetat thone se kjo lufte qe behet sot ne Shqiperi kunder revizjonizmit, eshte shume me heroike se ajo e Skenderbeut (qeshin me ironi)"......" Po ti s'ke vrar njeri, moj mami.... Kryetari z'di gje dhe s'ka gje ne dore, pa le qe dashka te dije dhe ç'far mendimesh ke ti".

Perpara b.p. "Flutura" eshte shprehur: " Babai im nuk ka bere ndonje gabim, ai nuk ka pasur ndonje aventur. Edhe kur e hoqen nga minister, ai e kerkoi arsyen, por ate e burgosen dhe nuk i kane bere gjyq........ , eshte djegur nga te tjeret, ai ka pasur mjaft besim tek njerzit, pa pasur parasysh se mund te digjej.

AIDSSH

Relacion i datës 20.6.1975

MEDIA FAQE #2



(21

- 2 -

Nga korespondenca e saj, kryesisht me ate t' jatit saje, del se me rastin e pervejetorit te ditlindjes tije i shkruan: " ........ Te uroj qe jeta te mos tregohet me aq e ashper me ty, siç eshte treguar deri tani, sepse ti je i forte dhe e ke duruar ç'do gje i qete, se pse ti me gjithe ate, gjithmone e ke dashur jeten".

Eshte konstatuar se shoqerohet dhe mban lidhje me njerez te dyshimte .

Prandaj, me qene se nuk jane sqaruar plotesisht dyshimet qe kemi ne drejtim te saj dhe nga ana tjeter ne te dhenat qe kemi per nenen e saj, del se Drita perkrah pikpamjet e objektes" si dhe te mbeshtetur ne udhezimin qe jepet ne shkresen e Drejtorise I.re. Nr. I435, dat. 2.4.I975;

V E N D O S A:

Qe te propozoj zgjatjen e afatit te perpunimit P.P. te Drita Maqo Comos edhe per 1 muaj kohe. Mbas miratimit te ketij vendimi do te bej ndryshimet e nevojshme ne kartoteke.

Puntori Operativ:

( Lutfi Nikaj )

ZV.KRYETAR'I DEGES P.BRENDESHME

/ QEMAL AHMETI /

AIDSSH

INFORMACION

## Relacion i datës 20.6.1975

| | |
|---|---|
| FONDI | Operativ |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Formulare |
| DOSJA | Nr. 3497 |
| VITET EKSTREME | 1974-1983 |
| SASIA E FLETËVE | 101 |
| DATA E KRIJIMIT | 20.06.1975 |
| PUNETORI OPERATIV | Lutfi Nikaj |
| GJUHA | Shqip |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Relacion |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #7

# Vendim i datës 15.07.1975

MEDIA FAQE #1



(20

"M I R A T O H E T"

KRYETAR' I DEGES PUNVE TE BRENDESHME

/ GEZIM HILA /

Elbasan,me 20/6/1975

V E N D I M :

Mbi zgjatjen e afatit te perpunimit P.P. per 1 muaj te

Drita Maqo Como(Belishova)

Une, Puntori Operativ Lutfi Nikaj, mbasi studjova materjalet ne ngarkim te Drita Maqo Comos;

G J E T A:

Se, Drita Como, eshte marre ne perpunim P.P., me daten. 26.12.1974, per agjitacion e propagande si lidhje e elementit anti-parti (vajza e Liri Belishoves).

Nga masat agjenturalo operative qe jane marre ne drejtim te saj, kane dale keto te dhena me te rendesishme:

Nga pergjimet me T.O. te organizuar me banesen e saje, ne biseda me t'jemen dhe vellain e saje eshte shprehur: "...... Kurse ne Shqiperi, ndodh e kunderta, librat shqipe flasen per jeten, por ato perndimoret flasen me bukur. Ata kane vepra te shkrimtarve te medhenj, nuk kane vepra te shkrimtarve te vegjel si ketu"....."Po gazetat thone se kjo lufte qe behet sot ne Shqiperi kunder revizjonizmit, eshte shume me heroike se ajo e Skenderbeut (qeshin me ironi)"......" Po ti s'ke vrar njeri, moj mami.... Kryetari z'di gje dhe s'ka gje ne dore, pa le qe dashka te dije dhe ç'far mendimesh ke ti".

Perpara b.p. "Flutura" eshte shprehur: " Babai im nuk ka bere ndonje gabim, ai nuk ka pasur ndonje aventur. Edhe kur e hoqen nga minister, ai e kerkoi arsyen, por ate e burgosen dhe nuk i kane bere gjyq....... [redacted], eshte djegur nga te tjeret, ai ka pasur mjaft besim tek njerzit, pa pasur parasysh se mund te digjej.

Vendim i datës 15.07.1975

MEDIA FAQE #2



(21

- 2 -

Nga korespondenca e saj, kryesisht me ate t' jatit saje, del se me rastin e pervejetorit te ditlindjes tije i shkruan: " ........ Te uroj qe jeta te mos tregohet me aq e ashper me ty, siç eshte treguar deri tani, sepse ti je i forte dhe e ke duruar ç'do gje i qete, se pse ti me gjithe ate, gjithmone e ke dashur jeten".

Eshte konstatuar se shoqerohet dhe mban lidhje me njerez te dyshimte .

Prandaj, me qene se nuk jane sqaruar plotesisht dyshimet qe kemi ne drejtim te saj dhe nga ana tjeter ne te dhenat qe kemi per nenen e saj, del se Drita perkrah pikpamjet e objektes" [redacted] si dhe te mbeshtetur ne udhezimin qe jepet ne shkresen e Drejtorise I.re. Nr. I435, dat. 2.4.I975;

V E N D O S A:

Qe te propozoj zgjatjen e afatit te perpunimit P.P. te Drita Maqo Comos edhe per 1 muaj kohe. Mbas miratimit te ketij vendimi do te bej ndryshimet e nevojshme ne kartoteke.

Puntori Operativ:

( Lutfi Nikaj )

ZV.KRYETAR'I DEGES P.BRENDESHME

/ QEMAL AHMETI /

Vendim i datës 15.07.1975

INFORMACION

# Vendim i datës 15.07.1975

| | |
|---|---|
| FONDI | Operativ |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Formulare |
| DOSJA | Nr. 3497 |
| VITET EKSTREME | 1974-1983 |
| SASIA E FLETËVE | 101 |
| DATA E KRIJIMIT | 20.06.1975 |
| PUNETORI OPERATIV | Lutfi Nikaj |
| APROVUAR NGA | Gëzim Hila (kryetar i degës së punëve të brendshme Elbasan) |
| GJUHA | Shqip |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Vendim |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #8

# Shtojcë plani masash, datë 20.9.1975

MEDIA FAQE #1

(27

"M I R A T O H E T"

SHEFI I SEKSIONIT

(Mehmet Tepelena)

Elbasan,me 20/9/75

SHTOJCE PLAN MASASH

PER PERPUNIMIN P.P. TE DRITA MAQO COMOS(BELISHOVA)

Nga perpunimi qe i eshte bere deri tani perpunimit P.P. te Drita Comos, materjalet ne ngarkim te saj nuk jane sqaruar plotesisht, prandaj del nevoja qe te ngreme edhe keto detyra:

I. B.p. " Flutura" qe eshte terhequr dhe ka dhene informata ne ngarkim te Drita Comos, do te vazhdoje drejtimi i saje per te sqaruar keto probleme:

- Si jane sjelljet e saja ne shkolle dhe jashte ne shoqeri.
- Si reagon ndoj programeve mesimore ne shkolle.
- Si reagon ndoj aktiviteteve shoqerore qe organizohen ngashkolla.
- Si reagon ndoj bisedave, informacioneve politike dhe leximit te shtypit qe behet ne shkolle.
- Si reagon per avenirin e saj ne te ardhmen
- Si reagon ndoj veprimtarise armiqesore te prinderve te saj (internim dhe burg)
- Ne se mban ditare e ben shkrime, cila eshte permbajtje e tyre.
- Cili eshte rrethi i saj shoqeror.

Detyra keto qe do ti jepen vazhdimisht
Kryhen nga POPL Lutfi Nikaj

2. Do te drejtohet b.p. "Shqiponja", per te sqaruar keto probleme:

- Si eshte sjellja dhe qendrimi i saj ne shtepi
- Si e kalon kohen e lire jashte shkollore
- Si i ka mardhenijet me pjestaret e familjes
-- Si reagon ndaj veprimtarise armiqesore te

AIDSSH

Shtojcë plani masash, datë 20.9.1975

MEDIA FAQE #2

(28

- 2 -

prinderve te saj.

- Kush i shkon ne shtepi,duke verifikuar personat dhe karakterin e shkuarjes.

Detyra qe do te kryhen deri 30.XI.75
Kryhen nga P.OP. Lutfi Nikaj

3. Nga e dhena e Rezidentit "Luani", del se Drita Como, shoqerohet me vajzen e agjentit "Rozafa" qe mbahet ne lidhje nga Ekonomija. Prandaj, do te koordinohet dhe udhezohet b.p. "Rozafa" qe nepermjet vajzes tije te nxjerre se si reagon Drita Como ndaj prinderve te saj lidhur me goditjen si dhe per jeten e perditshme.

Detyre qe do te kryhet deri me 30.12.1975
Kryejne P.OP. L.Nikaj dhe L.Veshi.

4. Nga edhena e reziderit "Hidrogjeni", del se qytetari [redacted] nga [redacted] eshte takuar dhe ka biseduar me Drita Comon, [redacted]. Per kete do te korespondohet me Degen e P. Brendeshme [redacted] per te pare te kaluaren dhe qendrimin e [redacted]

Detyre qe do te kryhet deri me 30.X.1975
Kryhet nga P.OP. Lutfi Nikaj

5. Do te merret ne surveim kur te vije ne Elbasan me qellim per te nxjerre lidhjet e kontaktet e saja me persona te dyshimte.

Detyre qe do te kryhet deri me 30.12.1975
Kryhet nga P.OP. Lutfi Nikaj

6. Do te vihet ne kontroll postar korespondenca e saje per te nxjerre lidhjet qe ka jashte rrethit.

Detyre qe do te kryhet deri me 30.12.1975
Kryhet nga P.OP. Lutfi Nikaj

7. Do te organizohen her mbas here pergjime me T.O. ne banesen e saje per te pare qendrimin dhe veprimtarine armiqesore te perbashket me nenen e saj.

Detyre qe do te kryhet deri me 30.12.1975
Kryhet nga P.OP. Lutfi Nikaj

Puntori Operativ:
( Lutfi Nikaj )

AIDSSH

INFORMACION

# Shtojcë plani masash, datë 20.9.1975

| | |
|---|---|
| FONDI | Operativ |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Formulare |
| DOSJA | Nr. 3497 |
| VITET EKSTREME | 1974-1983 |
| SASIA E FLETËVE | 101 |
| DATA E KRIJIMIT | 20.09.1975 |
| GJUHA | Shqip |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Shtojcë plani masash |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #9

# Raport realizimi detyrash, datë 10.01.1976

MEDIA FAQE #1



34

R E L A C I O N:

"Mbi realizimin e detyrave te ngritura ne drejtim te Drita Comos"

Detyrat e ngritura ne shtojcen e planit te masave dat. 20/9.1975, ne drejtim te perpunimit P.P. te Drita Comos, jane realizuar si ma posht:

Eshte drejtuar ne menyre te vazhdushme b.p. "Flutura", e cila ka dhene disa informata, qe tregojne se Drita Como eshte ne pozita armiqesore dhe se si ajo reagon ne disa momente te caktuara per probleme te ndryshme aktuale.

Eshte drejtuar b.p. "Shqiponja", me qene se eshte ne afersi te baneses saj, e cila me perjashtim te sinjalizimeve per levizje e kontakte me persona te ndryshem, ndonje materjal tjeter me vlere te madhe operative , nuk ka dhene.

Me qene se objektia shoqerohej me vajzen e agjentit "Rozafa", i cili mbahet ne lidhje nga sek. Ekonomise, eshte koordinuar dhe drejtuar ky b.p., qe te nxjerre ndonje materjal indirenkt nga vajza e tij, por nuk na ka dhene ndonje materjal ne kete drejtim.

Eshte koresponduar me Degen e P.Brendeshme [redacted], per te na sqaruar poziten e qytetarit [redacted]., i cili eshte takuar ne nje rast me objekten tone, por deri tani nuk jane pergjigjur.

Eshte marre ne surveim kur ka ardhur ne Elbasan sidomos me t'jemen, por ndonje lidhje me interes nuk na ka dale.

Nga kontrolli i korespondences, nuk ka dale ndonje materjal me vlere operative.

Jane organizuar her mbas here pergjime ne banesen e saj dhe reagimet , jane nxjerre ne faqen 26. te dosjes Nga keto pergjime, del se ne mjaft raste, ajo shprehet armiqesisht kunder partise e pushtetit dhe si domos ndaj masave qe jane marre karshi babes e nenes saj.

Gjithashtu eshte aktivizuar agjenti "Tomorri", qe eshte ne afersi te baneses saj, por edhe ai me perjashtim te disa konstatimeve te jashteme, nuk ka dhene ndonje materjal me vlere operative.

Te nisur nga fakti qe si te dhenat e b.p. "Flutura" dhe

AIDSSH

Raport realizimi detyrash, datë 10.01.1976

MEDIA FAQE #2



pergjimet me T.O., del se objektia eshte ne pozita armiqesore si dhe nga fakti qe eshte e bija e Liri Belishoves dhe e Maqo Comos, do te propozoj qe Drita Como te ngrihet ne perpunim 2.A., me qellim qe nepermjet saj, te perpunojme dhe nenen, Liri Belishoven.

Puntori Operativ:

(Lutfi [illegible] )

Elbasan,me IO.I.I976

AIDSSH

INFORMACION

# Raport realizimi detyrash, datë 10.01.1976

| | |
|---|---|
| FONDI | Operativ |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Formulare |
| DOSJA | Nr. 3497 |
| VITET EKSTREME | 1974-1983 |
| DATA E KRIJIMIT | 10.01.1976 |
| PUNETORI OPERATIV | Lutfi Nikaj |
| GJUHA | Shqip |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Raport |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #10

# Vendim i datës 10.02.1976

MEDIA FAQE #1

(35

"M I R A T O H E T' "S e k r e t"

KRYETAR'I DEGES PUNVE TE BRENDESHME

/ GEZIM HILA /

11.2.976.

Elbasan,me 10/II/1976

V E N D I M

"MBI NGRITJEN NGA PERPUNIMI PARAPRAK NE 2.A. TE

DRITA MAQO COMOS (BELISHOVA)

Une, Puntori Operativ Lutfi Nikaj, mbasi studjova materjale e dosjes ne perpunim P.P. te Drita Comos;

G J E T A

Se, Drita Como, eshte e bija e Maqo Comos dhe e Liri Belishoves, e dat-lindjes 1958, lindur ne lagjen "[redacted]", te qytetit Tiranes dhe banus ne qytetin e Cerrikut te rrethit Elbasan, me arsim vazhdon vitin e fundit te gjimnazit, e pa martuar, e pa organizuar, e pa denuar, rrjedh nga shtrese N/Punsesh, me kombesi e shtetesi shiptare.

Deri ne vitin 1960, prindrit e saj kaneqene me fuksione te rendesishme Partie e Pushtet. Ne kete kohe qe te dy, per veprimtari anti-parti, jane goditur e hedhur jasht radhve te partise. Aktualisht babai saj eshte i burgosur per veprimtari armiqesore, ndersa nena qe nga ajo kohe vazhdon me masen e internimit si elemente me rrezikshmeri te theksuar armiqesore dhe si e tille perpunohet aktivisht ne 2.A. Dajua i saj [redacted] eshte i denuar per aktivitet armiqesor me 25. vjet burg. Ndersa dajallaret e tjere, [redacted], [redacted], [redacted] dhe [redacted] ndiqen nga organet tona si element anti-parti.

Me daten 24.12.1974, u muar ne perpunim P.P. si lidhje e elementit anti-parti dhe me daten 15.7.1975, i u zgjat afati edhe 6 muaj kohe.

Nga perpunimi paraprak qe i eshte bere, ne ngarkim te saj, kane dale keto te dhena:

ADSH

Vendim i datës 10.02.1976

MEDIA FAQE #2

(36

- 2 -

Perpara b.p. " Flutura", eshte shprehur: " Babai im nuk ka bere ndonje gabim, ai s'ka bere ndonje aventure. Kur e hoqen nga minister dhe pse e kerkoi arsyen, e burgosen dhe nuk i kane bere gjyq". Mami e beri gabimin, por edhe i falet se ka nje far te drejte se ishin hapat e para te pushtetit popullor".... " Grevat e demostratat ne vendet kapitaliste, behen per ndrrimin e ngjyrave, se i duan ti kene te kalter ose te kuqe, atje ka mirqenije te larte se eshte e zhvilluar industria shume".

Nga pergjimet e bera me T.O., ne banesen e saj, duke bisseduar me nenen dhe vellain e saj, eshte shprehur: " Ne Shqipri me librat ndodh e kunderta, me ato perndimoret, se n'ato perndimoret flitet me bukur, se ato kane vepra te shkrimtarve te medhej, nuk kane vepra te shkrimtarve te vegjel si keta". "Gazetat thone se kjo lufte qe behet sot ne shqipri kunder revizjonizmit, eshte shume me heroike se ajo e Skenderbeut"......" Po ti as ke vrar njeri moj mami". Po nga T.O., del se nenje rast, kur nje shkrimtar u ka folur ne shkolle per shkrimet ne vendin tone, eshte shprehur me ironi: " Ja avazi i mukes, jane bere gabime si Fadil Paçrami, me qe ka dashur te mohoje frymen popullore, ai po permbyste boten"...... "Ne socializem, ose me mire te themi ne Shqipri, qe e ha telin njeqintmij her me shume se sa ne kohen qe jetonte Andershteni"(shkrimtar borgjez). "Po tani keta moj mami, duan te gacmojne, une habitem, ç'u kujtua udhëheqësi kryesor me ty. Ti nevrikosesh kot dhe me cilet, me keta.....dole prap ne skenen politike ti".... "Tani ne kete situate [redacted]

Nga korespondenca, kryesisht me baben e saj, me rastin e 50 vjetorit te dit-lindjes, nder tetjera i shkruan: "...... Te uroj qe jeta te mos tregohet me aq e ashper me ty siç eshte treguar deri tani, sepse ti je i fort dhe i ke duruar ç'do gje i qet, sepse ti me gjith ate, gjithmone e ke dashur jeten".

Eshte konstatuar se ne rrethin e saj shoqeror, afron me teper [redacted], [redacted] e [redacted], te cilet jane me perberije te keqe politike

Nga tedhenat e siperme,del se Drita Como, diskuton dhe mbe

ADSH

MEDIA FAQE #3



37

\- 3 -

shtet plotesisht mendimet e pikpamjet armiqesore te nenes saj Liri Belishoves, kunder partise e sistemit socialist.

Me qene se materjalet ne ngarkim te saj vertetohen se kjo zhvillon veprimtari armiqesore neformen e agjitacionit e propagandes

V E N D O S A:

Qe Drita Comon, ta ngre nga perpunimi P.P. ne 2.A., me tendencen e agjitacionit e propagandes, me qellim per te zbuluar se deri ne ç'far shkelle shtrihet aktiviteti i saj armiqesor, per ta dekumentuar, nderprere e goditur. Mbas miratimit te ketij vendimi, do te behen ndryshimet perkatese ne kartoteke.

Puntori Operativ: (Lutfi Nikaj)

Shefi i Seksionit: (Mehmet Tepelena )

D' A K O R T
ZV. KRYETAR'I DEGES PUNVE TE BRENDESHME
/ QEMAL AHMETI /

AIDSSH

Vendim i datës 10.02.1976

INFORMACION

# Vendim i datës 10.02.1976

| | |
|---|---|
| FONDI | Operativ |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Formulare |
| DOSJA | Nr. 3497 |
| VITET EKSTREME | 1974-1983 |
| DATA E KRIJIMIT | 101 |
| PUNETORI OPERATIV | Lutfi NIkaj, Mehmet Tepalena (shef seksioni) |
| APROVUAR NGA | Gëzim Hila |
| GJUHA | Shqip |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Vendim |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #11

# Plan masash agjenturalo-operative

MEDIA FAQE #1



66

M I R A T O H E T
ZV/KRYETARI I DEGES P.TE BRENDESHME
/ QEMAL AHMETI /

S E K R E T
Elbasan,me 10.II.197

P L A N - M A S A S H
AGJENTURALO OPERATIVE PER DRITA COMON NE PERPUNIM 2/A

Me qellim qe te zbulojme me ne thellesi aktivitetin armiqsore te objektes Drita Como,e cila ndiqet lidhje e elementit antiparti (nenes saj Liri Belishova),do te meren keto masa agjenturalo-operative:

1) Do te drejtohet b.p."Flutura" me detyra konkrete,e cila do te na sqaroje keto ceshtje:

- si reagon objektja lidhur me sherbimin shendetsore qe behet tek ne,vecanarisht per semundjes e saj.
- cilet persona kane shkuar per t'a vizituar ne spital kur ka qene e shtruar ne Tirane dhe cilet i vijne tani aktualisht
- si e komenton ajo,zhvillimin e festivalit te 15-te te kenges ne radio televizor.

Kryen P.OP. Lutfi Nikaj deri 30.IV.1977.
Kontrollon shefi i Seksionit Selman Rada.

2) Te drejtohet agjenti "Tomorri",i cili do te na sqaroje keto ceshtje:

- cilet persona hyjne e dalin ne shtepine e objektes dhe karakteri i ketyre lidhjeve.
- si reagon objektja,lidhur me riarrestimin e babait te saj Maqo Como.
- cilat jane pikpamjet e kesaj objektje,lidhur me konkretizimin ne praktike te materjaeve te Kongresit te 7 PPSH.

Kryen Puntori Operativ Selman Rada deri 20.V.1977
Kontrollon zv/Kryetari i Deges Q.Ahmeti.

3) Te aktivizohet b.p."Studjuesei" i cili ka dhene dy te dhena ne drejtim te kesaj objektje,i cili do te sqaroje:

Plan masash agjenturalo-operative

MEDIA FAQE #2



67

- 2 -

- cila eshte gjendja shendetsore e objektes Drita Como.
- te na sinjalizoje sa here qe kjo objekte do te mari rekomandim dhe do te shkoje per vizite ne Tirane.
- nepermjet vizites me objekten Drita Como,te afrohet ne biseda me nenen e saj Liri Belishova,
- nepermjet bisedave me Drita Comon,te mesoje aktivitetin armiqsore te nenes saj,per disa probleme te caktuara.

Kryen puntori operativ Selman Rada 15.III.77
Kontrollon zv/kryetari i deges.

4) Te koordinohen veprimet me puntorin operativ te zones Cerrikut shokun Dilaver Balili,meqellim qe b.p."Sportisti t'i ngarkohen detyra per te kontrolluar levizjet dhe kontaktet e saj ne qytetin e Cerrikut.

Kryen puntoret operativ S.Rada e D.Balili.
Kontrollon zv/kryetari i deges Q.Ahmeti.

5) Here pas here te organizohen pergjime me T.O. ne banesen e saj duke shfrytezuar situatat e ndryeshme,ose te krijuara nga ne,meqellim qe te fiksojme dhe dokumentojme veprimtarine armisore te kesaj objekte,e lidhur kjo me ate nenes saj.

Kryen puntori operativ Selman Rada(vazhdimi)
Kontrollon zv/kryetari i deges Q.Ahmeti.

6) Sa here qe do te vije ne qytetin e Elbasanit,ose do te shkoje ne Tirane per vizite,te meren masa per survehjimin e saj dhe te njoftohet menjehere Dega e Vecante.

Kryen puntori operativ Selman Rada(vazhdim)
Kontrollon shoku Qemal Ahmeti.

7) Perpunimi i kesaj objektje,do te ndiqet i perbashke me te nenes saj,meqellim qe nepermejet saj,te arrijme per te zbuluar aktivitetin armiqsore te Liri Belishoves.

8) Ne vartesi me materjalet e grumbulluara,do te behet relacioni mbi realizimin e detyrave dhe do te konkludohet per detyra te metejshme.

Puntori Operativ
/ Selman Rada /

Plan masash agjenturalo-operative

INFORMACION

## Plan masash agjenturalo-operative

| | |
|---|---|
| FONDI | Operativ |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Formulare |
| DOSJA | Nr. 3497 |
| VITET EKSTREME | 1974-1983 |
| SASIA E FLETËVE | 101 |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | Cërrik, Elbasan, Tiranë |
| DATA E KRIJIMIT | 10.02.1976 |
| GJUHA | Shqip |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #12

# Vendim i datës 24.02.1977

MEDIA FAQE #1



69

M I R A T O H E T
Zv. ministri P. Brendeshme
( Fecor Shehu )

S E K R E T
Ekzemplar i vetem.
Tirane 24/II/1977.

V E N D I M
MBI ZGJATJEN E AFATIT PER 6 MUAJ TE OBJEKTES
DRITA MAQO COMOS

Une,puntori operativ i Deges Punve te Brendeshme Elbasan,Selman Rada,mbasi studjova materjalet qe disponohen ne dosjen formulare Nr.1554 te perpunimit aktiv 2/A ne ngarkim te Drita Comos dhe;

G J E T A :

Se Drita Como,eshte e bija e Maqos dhe e Lirise,e datelindjes 1958,lindur ne Tirane dhe banues ne qytetin e Cerrikut,me aresim te mesem,e pa martuar,e pa denuar ndonjehere, e pa organizuar,me shtetesi e kombesi Shqipetare.

E permendura me daten 11.2.1976,eshte mare ne perpunim 2/A,si lidhje e elementit antiparti(vajza e Liri Belishove

Gjate perpunimit te ketij objekti,jane mare 10 raporte agjenturale nga bashkepuntoret "Tomorri","Studjuesi" dhe "Flutura",si dhe 5 informacione te T.O. qe bejne te qarte se objektja zhvillon veprimtari armiqsore ne formen e agjitacionit e propagandes,duke perkrahur e mbeshtetur plotesisht mendimet e pikpamjet armiqsore ne drejtim te Partise e Shtetit,te cfaqura nga nena e saj Liri Belishova.

Meqenese nga perpunimi i deri tanishem i ketij objekti,nuk kemi mundur te zbulojme dhe dokumentojme veprimtarine e tij armiqsore,kjo per faktin se gjate gje perjudhe prej 4 muajsh ka qene e shtruar ne spital,mbeshtetur ne rregulloren e evidences operative Nr.01-1 date 15.I.1977;

AIDSSH

Vendim i datës 24.02.1977

MEDIA FAQE #2



70

- 2 -

V E N D O S A :

Qe te propozoj zgjatjen e afatit per 6 muaj te objektes Drita Maqo Como,meqellim per te zbuluar dhe dokumentuar veprimtarine e saj armiqsore,si lidhje e elementit antiparti.

Mbas miratimit,te bej ndryshimet ne sektorin e evidences

Puntori operativ
/ Selman Rada /

Zv/Kryetari i Deges P.Brendeshme
/ Qemal Ahmeti /

D a k o r t
Kryetari i Deges P. te Brendeshme
/ Gezim Hila /

Shenim!
Me qene se Drita Como eshte e semure dhe e shtruar ne spital dhe semundje e saj, simbas mjekeve, paraqitet e rende, mendojme qe te hiqet nga perpunimi per sa kohe qe ajo eshte e semure. (Kjo me porosi te zv.ministrit)
[illegible]

5-3-77

AIDSSH

Vendim i datës 24.02.1977

INFORMACION

# Vendim i datës 24.02.1977

| | |
|---|---|
| FONDI | Operativ |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Formulare |
| DOSJA | Nr. 3497 |
| VITET EKSTREME | 1974-1983 |
| SASIA E FLETËVE | 101 |
| DATA E KRIJIMIT | 24.02.1977 |
| PUNETORI OPERATIV | Selman Rada |
| APROVUAR NGA | Gëzim Hila (Kryetar i Degës së Punëve të Brendshme Elbasan) |
| GJUHA | Shqip |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Vendim |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #13

# Vendim i datës 30.11.1980

MEDIA FAQE #1



73

MIRATOHET
ZV/KRYETARI I DEGES P.TE BRENDESHME
QEMAL AHMETI

SEKRET
Elbasan,me 30.11.1980

VENDIM
PER TERHEAJEN NGA ARKIVI DHE MARJEN NE KONTROLL
OPERATIV 2/B TE DRITA MAQO COMOS

Une Selman Rada,punetor operativ prane deges puneve te brendeshme Elbasan,mbasi studjova materjalet e dosjes formulare 2/A te arshivuar me Nr.1554 ne ngarkim te Drita Comos,per agjitacion e propagande armiqsore:

GJETA

Se Drita Como eshte e bija e Maqos dhe e Lirise,e datelindjes 1958,lindur ne Tirane dhe banuese ne qytetin e Cerrikut,me arsim te mesem,e pa martuar,e pa denuar ndonjehere,me pune ne ndermarjen komunale Cerrik,shtrese e pasur,me shtetesi e kombesi Shqipetare.

Deri ne vitin 1960 prinderit e saj kane qene me funksione te rendesishme Partie e Pushteti,kohe ne te cilen te dy per veprimtari antiparti,jane goditur e perjashtuar nga rradhet e Partise.Aktualisht babai i saj Maqo dhe dy dajallaret [redacted] e [redacted] Belishova ndodhen ne burg per veprimtari armiqsore,ndersa nena e saj Liria dhe vellai [redacted] jane te internuar ne qytetin e Cerrikut.

Me daten 24.XII.1974,Drita Como eshte mare ne P.P. dhe me daten 11.XII.1976 eshte ngritur ne perpunim 2/A per agjitacion e propagande per drejtimin antiparti.Me daten 7.4.1977 dosja e saj eshte arshivuar,meqense eshte shtruar ne spitalin ankologjik Tirane dhe sipas mjekeve paraqet rrezikshmeri per jeten.

Vendim i datës 30.11.1980

MEDIA FAQE #2



74

- 2 -

Duke u nisur nga qendrimi politik jo i mire i saj,si dhe faktin se ne rrethana e konjuktura te caktuara mund te riaktivizohet ne veprimtari armiqsore kundra Partise e shtetit,i udhehequr nga rregullorja e evidences agjenturalo operative Nr.01-32 date 20.X.1977

VENDOSA

Te terheq nga arkivi dosjen e arshivuar 2/A ne ngarkim te Drita Maqo Comos dhe t'a marr ate ne kontroll operativ 2/B me tendence agjitacion e propagande armiqsore per drejtimin antiparti

Mbas miratimit,te bej ndryshimet ne kartoteke.

Punetori Operativ
Selman Rada

Shefi i Seksionit Grupimeve
Sofokli Duka

Vendim i datës 30.11.1980

INFORMACION

# Vendim i datës 30.11.1980

| | |
|---|---|
| FONDI | Operativ |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Formulare |
| DOSJA | Nr. 3497 |
| VITET EKSTREME | 1974-1983 |
| SASIA E FLETËVE | 101 |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | Elbasan |
| DATA E KRIJIMIT | 30.11.1980 |
| PUNETORI OPERATIV | Selman Rada |
| APROVUAR NGA | Qemal Ahmeti |
| GJUHA | Shqip |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Vendim |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #14

# Vendim arshivimi pas vdekjes, datë 13.03.1983

MEDIA FAQE #1



75

MIRATOHET
KRYETARI I DEGËS P.TË BRENDËSHME
GËZIM HILA

"Sekret"
Ekzemplar i vetëm.
Elbasan, më 18.3.1983.

VENDIM
MBI ARSHIVIMIN E DOSJES FORMULARE TË DRITA COMOS
NË KO/2B.

Unë punëtori operativ Sofokli Duka, efektiv i Degës së Punëve të brendëshme Elbasan, pasi studiova dhe analizova materialet që gjënden në dosjen formulare Nr.3235, ecila i përket Drita Comos në KO/2B, për drejtimin antiparti;

GJETA:

Drita Como, është e bija e Maqos dhe Lirisë, e datëlindjes 1958, lindur në Tiranë, me arsim të mesëm, e pa martuar, e pa dënuar, me origjinë sociale shtresë e pasur, me kombësi e shtetësi shqipëtare.

Dëri në vitin 1960, prindrit e saj kanë qënë me funksione të rëndësishme partie e pushteti e pas kësaj të dy ata janë goditur dhe përjashtuar nga rradhët e Partisë si element antiparti. Babai i saj Maqoja, si dhe dy dajallaret [redacted] dhe [redacted]. janë duke vuajtur q dënimin për veprimtari armiqësore, ndersa nëna dhe vëllai [redacted], janë të internuar në qytetin e Cerrikut.

Më 24.12.1974, Drita Como është marë në përpunim P.P. dhe më 11.12.1976 është ngritur në 2/A, për agjitacion dhe propagan armiqësore.Më 7.4.1977, dosja eshte arshivuar, pasi ajo u shtrua në spitalin onologjik dhe më 30.11.1980, ajo u mor në KO/2B me tenden cën e mësipërme. Kohet e fundit Drita Como ka vdekur , duke qënë e sëmurë [redacted].

Të nisur sa sipër dhe në mbështetje të rregullores së evidencës agjenturalo operative, Nr.01-32, datë 20.10.1977;

VENDOSA:

Dosjen në KO/2B, Nr.3235, që i përket Drita Comos për drejtimin antiparti, ta arshivoj pranë degës së punëve të brendëshm Elbasan për 10 vjet kohë, për vlera operative dhe studimore, duke bërë edhe ndryshimet në kartotekë.

PUNËTORI OPERATIV
SOFOKLI DUKA

P.OP.I DREJTIMIT
PETRAQ MILO

SHEFI SEK.PËRGJI.
QEMAL SOKOLI

DAKORT
ZV.KRYETARI DEGËS P.TËBRENDËSHME
LUAN GJONGA

AIDSSH

Vendim arshivimi pas vdekjes, datë 13.03.1983

INFORMACION

## Vendim arshivimi pas vdekjes, datë 13.03.1983

| | |
|---|---|
| FONDI | Operativ |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Formulare |
| DOSJA | Nr. 3497 |
| VITET EKSTREME | 1974-1983 |
| SASIA E FLETËVE | 101 |
| DATA E KRIJIMIT | 18.03.1983 |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Vendim |
| GJUHA | Shqip |

| | |
|---|---|
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | Elbasan |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.